



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 27

Prishtinë, më 16 nëntor 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Behar Selimi, Arsim Bajrami, Ardian Gjini, Halit Krasniqi, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Amir Ahmeti dhe Jasmina Zhivkoviq.

Munguan: Haki Demolli dhe Mufera Şinik.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Muharrem Mustafa – ZPRK, Lumnije Murati – ZPRK, Floriana Shala -OSBE, Astrit Hoti – KGJK, Artan Canhasi – EULEX, Sefadin Blakaj- USAID, Adriana Çeta – ICO, Suzana Gashi - ICO dhe Fixhrije Dragaj – praktikante.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 05 dhe 12.09. 2011;
3. Shqyrtimi në parim i projektligjit për marrëdhëniet e detyrimeve;
4. Shqyrtimi i propozimeve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës nr. 04/L-70 me amendamentet e propozuara nga grupi punues;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-58 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike;
7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Shitjen e banesave, për të cilat ekziston e drejta banesore nr. 04/952/L-61;
8. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës;

9. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L- 54 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre;
10. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për buxhet dhe financa për Projektligjin nr. 04/L-17 për ndihmë juridike falas;
11. Shqyrtimi i kërkesës së organizatës “ ÇOHU “;
12. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

***Kryetari** propozoi që pika e gjashtë të hiqet nga rendi ditës, kurse në pikën të ndryshme të përfshihet:*

- Njoftimi komisionit lidhur me aktivitetin e grupit të punës për mbikëqyrjen e ligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.

Armend Zemaj - Propozoi që të hiqet nga shqyrtimi edhe pika 9, që ka të bëjë me shqyrtimin e raportit të Komisionit FunkSIONAL për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre, për arsye se deputetët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, që janë në këtë komision kanë paraqitur amendamentet e tyre, të cilat nuk janë përfshirë në këtë raport.

Albulena Haxhiu- Propozoi që edhe pika 4 e rendit të ditës të hiqet nga rendi ditës.

Rendi ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 05 dhe 12.09. 2011

***Kryetari** konstatoi se Komisioni i miratoi mbledhjet e mbajtura më 05 dhe 12.09. 2011, pa vërejtje.*

3. Shqyrtimi në parim i projektligjit për marrëdhëniet e detyrimeve

Kryetari- Theksoi se për këtë P/L kam menduar që të kemi disa aktivitete, ndër to edhe një dëgjim publik për grupet e interesit, të cilat mund të japin vlerësimet e tyre dhe të shprehin interesimin e tyre për këtë ligj, përfshirjen e ekspertëve të cilët mund të japin kontribut në këtë ligj, po ashtu kanë shfaqur interes edhe organizatat ndërkombëtare.

Armend Zemaj- U pajtua që ligjin duhet ta përcjellim për séancë plenare, mirëpo është një ligj voluminoz, andaj mendoj që duhet të formohet një grup punues, që do ta orientojë punën. Mendoj që kyçja e të gjithë anëtarëve do të jetë problematike.

Arsim Bajrami- Vlerësoi se pa dyshim ky do të jetë ligji më voluminoz që do ta kemi gjatë tërë legjislaturës, është me rëndësi t'i angazhojmë ekspertët sa ma shpejt, dhe duhet ta bëjmë një strategji të punës se si duhet të punohet, si do të punojnë grupet e ekspertëve a do të punojnë në ambiente të Kuvendit ose do të punojnë në punëtori.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri u pajtua që Kuvendit t’ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet, në parim, Projektligji për marrëdhëniet e detyrimeve, nr. 04/L-77

4. Shqyrtimi i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës nr. 04/L-70 me amendamentet e propozuara nga grupi punues

Amir Ahmeti, në cilësi të kryesuesit të grupit punues, e njoftoi Komisionin se grupi punues ka paraqitur 8 amendamente në P/L për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës. Ai dha sqarime për secilin amendament duke shtuar se këto ndryshime e bëjnë projektligjin më të plotë dhe të zbatueshëm dhe kërkoi që këto amendamente të përkrahen.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit për Legjislacion.

II. I rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës me amendamentet e propozuara.

Amendamenti 1

Neni 1

Në rreshtin e katërt, pas fjalës Kosovës, shtohen fjalët: “**Personat juridikë**” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 2

Neni 4

Në rreshtin e tretë, pas fjalës “publike”, shtohen fjalët: “**personave juridikë**” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 3

Neni 5

Titulli i nenit “**Dekoratat**”, hiqet dhe zëvendësohet me titullin “**Llojet e dekoratave**”

Amendamenti 4

Neni 7

Shtohet pika 1.4 dhe formulohet si vijon: **“Deputeti i Kuvendit të Kosovës”** dhe radhitja e pikëve të tjera të këtij neni bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 5

Neni 7, pika 1.6, pjesa e fjalisë **“në bashkëpunim me Kryeministrin e tyre”** hiqet.

Amendamenti 6

Neni 9, titulli i nenit riformulohet si vijon: **“Komisioni vlerësues për dhënien e dekoratave”**

Amendamenti 7

Neni 11 paragrafi dy (2), në rreshtin e dytë, fjala **“spikatura”** hiqet dhe zëvendësohet me fjalën **“veçanta”**

Amendamenti 8

Neni 19 në rreshtin e tretë, në fund të fjalisë, shtohet fjala **“ligj”**

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për Shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr. 04/952/L-61,

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për Shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore dhe nuk u paraqitën vërejtje nga anëtarët e Komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji për Shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.
6. **Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës**

Kryetari- Tha se sipas asaj që kemi diskutuar herën e fundit rezultoi që propozimi që është bërë është në kundërshtim me frymën e kushtetutës dhe me ligjet e tjera në Kosovë. Një përfaqësues i parlamentit të Republikës së Kosovës nuk mund të jetë pjesë edhe në Këshillin konsultativ për komunitete, prandaj ky amendament nuk duhet të përkrahet. Ai po ashtu i njoftoi anëtarët me shkresën e këshillit konsultativ për komunitete, e cila po ashtu arsyetoi se është në kundërshtim me frymën e kushtetutës që deputeti duhet të jetë edhe anëtar i këshillit konsultativ. Kështu që ne konkludojmë që deputeti obligativisht nuk duhet të jetë, le të hiqet fjala “ duhet “ dhe le të mbetet siç ka qenë në PL.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës.
 2. Amendamentet e propozuara nga Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përveç amendamentit 3.
 3. Komisioni për Legjislacion i sugjeron Komisionit Funksional që ta rishikojë amendamentin 3, sepse përmbajtja e tij përmban provizion detyrues që përfaqësimi në Këshillin konsultativ për komunitete të jetë deputeti nga radha e komuniteteve të përcaktuara. Ky provizion detyrues është në kundërshtim me qëllimin e projektligjit dhe i sugjerohet Komisionit Funksional që të mbetet si në projektligj.
 4. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim, përveç amendamentit 3.
- 7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për buxhet dhe financa për Projektligjin nr. 04/L-17 për ndihmë juridike falas**

U diskutua raporti i Komisionit për buxhet dhe financa për Projektligjin për ndihmë juridike falas, për të cilin diskutuan Arben Gashi, Arsim Bajrami, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Ardian Gjini. Amendamentet e propozuara për këtë PL nga Komisioni për buxhet dhe financa, për nenet: nenit 15, nënparagrafi 1.3; nenit 20, paragrafët 1 dhe 3; nenit 22, paragrafi 2.2, nënparagrafi 2.3; nenit 37, paragrafët 1 dhe 2 dhe nenit 39, nuk u përkrahen nga Komisioni për legjislacion.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri u pajtua që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet Projektligji për ndihmë juridike falas nr. 04/L-17 me amendamentet e propozuara nga komisionet.

8. Shqyrtimi i kërkesës së organizatës “ ÇOHU “

U shqyrtua kërkesa e organizatës “ Çohu “në lidhje me mosdeklarimin e pasurisë së zyrtarëve të Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit. Për këtë diskutuan: Arben Gashi, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu dhe Ardian Gjini.

Komisioni lidhur me këtë çështje vendosi që të kërkoj nga Agjencia si vijon :

- 1. Formularët e deklarimit të pasurisë për zyrtarët e Agjencisë Kundër Korrupsionit,*
- 2. Raport me shkrim rreth punës dhe aktiviteteve të Agjencisë për periudhën kohore sa Agjencia nuk kishte drejtor.*

9. Të ndryshme

- Njoftimi Komisionit lidhur me aktivitetin e grupit të punës për mbikëqyrjen e ligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.

Behar Selimi - E njoftoi Komisionin me aktivitete që ka bërë grupi punues për mbikëqyrjen e ligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar. Ai tha se jemi duke pregaditur raportin lidhur me aktivitetet e bëra dhe shumë shpejt do ta procedojmë në Komision.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisioni

Arben Gashi